



MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Vendore, 14 maj 2023

DEKLARATA E GJETJEVE DHE KONKLUZIONEVE PARAPRAKE

KONKLUZIONET PARAPRAKE

Zgjedhjet vendore të 14 majit në përgjithësi u administruan mirë, ishin konkurruese dhe u mbajtën me pjesëmarrjen e forcave kryesore politike, por procesi u karakterizua nga polarizimi i vazhdueshëm midis partive kryesore politike dhe një ndarje e thellë brenda opozitës. Garuesit mundën të bënin fushatën lirshëm, por çështjet me rëndësi për komunitetet vendore u shfaqën shumë pak në fushatë. Rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe votuesit, dhe akuzat për blerje votash ishin shqetësuese. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e organizoi punën e tij në mënyrë transparente dhe efikase, por stabiliteti i komisioneve të niveleve më të ulëta u ndikua negativisht nga zëvendësimi i shpeshtë i anëtarëve nga partitë propozuese. Rregullat për mbulimin politik të fushatës favorizojnë fuqishëm partitë kryesore dhe përdorimi i shpeshtë nga media i përmbajtjes së prodhuar nga partia në programet e lajmeve minoi mbulimin gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës. Dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishte paqësore, por u ndikua negativisht nga raste të shumta të ndërhyrjeve të partive në proces si dhe nga problemet teknike dhe procedurale, raste të shumta votimi në grup dhe probleme me fshehtësinë e votës. Numërimi i votave, në përgjithësi, u vlerësua pozitivisht.

Kuadri ligjor për zgjedhjet, i cili u ndryshua për herë të fundit në vitin 2020, ofron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, duke përfshirë edhe zgjedhjet vendore. Ndërkohë që një sërë rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it u adresuan në vitin 2020, shumë prej tyre nuk janë zbatuar ende. Disa kufizime për të drejtën e votës nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, disa dispozita të tjera të Kodit Zgjedhor nuk janë në një linjë me praktikën e mirë ndërkombëtare. Kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiakë zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetarë bashkie zgjidhen ata që kanë marrë numrin më të madh të votave dhe këshilltarët - sipas një sistemi proporcional me lista të mbyllura.

Në përgjithësi zgjedhjet u menaxhuan mirë nga administrata zgjedhore, megjithëse u vunë re disa vonesa në aspektet teknike të procesit dhe emërimin e komisioneve të niveleve më të ulëta. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e organizoi punën e tij në mënyrë transparente dhe efikase dhe shumica e bashkëbiseduesve të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) të ODIHR-it vunë re hapje dhe transparencë të shtuar në vendimmarrjen e KQZ-së. Partitë politike me të drejtë gare, përdorën gjerësisht të drejtën e tyre për të tërhequr anëtarët e komisioneve të niveleve më të ulëta. gjë që ndikoi në stabilitetin e administratës zgjedhore të nivelit më të ulët. Në këtë aspekt, partitë politike nuk arritën të përmbushin të drejtat dhe përgjegjësitë e shumta që iu dhanë atyre nga Kodi Zgjedhor.

KQZ-ja organizoi një projekt pilot për votimin elektronik në 401 nga 5,212 qendra votimi. Afati i shkurtër kohor për zbatimin e projektit nuk lejoi as edukimin e gjerë të votuesve dhe as auditim të pavarur të teknologjive të reja.

Listat e zgjedhësve përfshinë rreth 3.6 milionë zgjedhës me të drejtë vote, ku përfshihen një numër i konsiderueshëm zgjedhësish që jetojnë jashtë vendit. Ndërkohë që bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it, përgjithësisht, shprehën besim në saktësinë e listave të votuesve, disa prej tyre deklaruan se ndryshimi i fundit i qendrave të votimit mund të çorientonte zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve. Kufizimet në regjistrimin e votuesve lidhur me paaftësinë intelektuale dhe psikosociale nuk janë në

përputhje me objektivat e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.

Regjistrimi i kandidatëve ishte gjithëpërfshirës dhe në zgjedhje morën pjesë 40 parti dhe koalicione, si dhe 12 kandidatë të pavarur, me gjithsej 144 kandidatë për kryetar bashkie dhe 852 lista këshilli. Kufizimet ekzistuese të së drejtës për të marrë pjesë, në rastet kur mungon vendimi gjyqësor i formës së prerë, nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kandidatët e pavarur u përballën me kërkesa më të vështira për mbledhjen e nënshkrimeve.

Përgjithësisht, liritë themelore të tubimit dhe të shprehjes u respektuan dhe subjektet zgjedhore mundën ta bënin fushatën lirshëm. Votuesve iu paraqit mundësi e shumëllojshme zgjedhjeje, me zgjedhje këshillash që kaluan në plan të dytë krahasuar me zgjedhjen e kryetarëve të bashkisë. Fushata e dukshme, por jo e bujshme, u përqendrua rreth partive të mëdha dhe kryetarëve të tyre kombëtarë dhe përfshinte retorikë dhe stil kundërvënës në dëm të demokracisë vendore, në vend që të ishte një fushatë e përqendruar tek kandidatët dhe çështjet vendore.

Ndryshimet e vitit 2020 paraqitën masa të tjera mbrojtëse kundër abuzimit me burimet shtetërore. Megjithëse autoritetet nuk mund të propozojnë, të miratojnë ose të nxjerrin vendime që parashikojnë përfitime katër muaj para ditës së zgjedhjeve, pati aktivitete të shumta, si nga qeveria qendrore, ashtu edhe nga administratat e ndryshme vendore, që ranë ndesh me këtë rregull. Interpretimi i ngushtë dhe formal nga Komisioneri se kjo dispozitë zbatohet vetëm për zgjedhjet parlamentare, duke reflektuar më shumë gjermën dhe jo frymën e ligjit, nuk garantoi një nivel fushëloje. Shpesh, nuk pati asnjë dallim të qartë ndërmjet veprimtarive zyrtare dhe atyre të fushatës. Në disa raste, mbështetja e ardhshme e qeverisë për bashkitë ishte e kushtëzuar nga rezultati zgjedhor. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it parashtruan gjithashtu ankesa ku pretendohet vënia nën presion e votuesve dhe blerja e votave.

Trembëdhjetë nga 17 ministrat e qeverisë dhe 50 nga 140 anëtarët e parlamentit (35 përqind) janë femra. Edhe pse ligji parashikon kuotën gjinore prej 50 për qind dhe kriteret e vlerësimit, nuk u respektuan gjithmonë. Përveç kësaj, vetëm 15 nga 144 kandidatët për kryetar bashkie ishin femra. Edhe pse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind, femrat janë të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse.

Garuesit mund të financojnë fushatat e tyre me fonde publike dhe private. Ligji parashikon kufizime për donacionet dhe për shpenzimet e fushatës. Garuesve nuk u kërkohet të deklarojnë publikisht përpara ditës së zgjedhjeve burimin dhe sasinë e fondeve të mbledhura dhe duhet vetëm të dorëzojnë raporte financiare pas ditës së zgjedhjeve, gjë që pakëson transparencën. Shpërndarja e vonuar e fondeve të fushatës publike, të cilat përdoren për llogaritjen e kufijve të shpenzimeve, si dhe miratimi me vonesë i rregullave dhe udhëzimeve për raportimin e financimit të fushatës, cënuan sigurinë ligjore.

Kuadri ligjor për median në përgjithësi ofron garanci për lirinë e shprehjes dhe njohjen me informacion; megjithatë, dispozitat ligjore në lidhje me njohjen me informacion nuk zbatohen në mënyrën e duhur. Edhe pse i larmishëm, mjedisi mediatik karakterizohet nga probleme sistemike, duke përfshirë përqendrimin e pronësisë së medias dhe kontrollin e ushtruar nga interesa të ndërthurura të biznesit dhe politikës, të cilat ndikojnë në lirinë e medias dhe gazetarinë. Rregullat për mbulimin në lajme dhe programe informative u japin partive kryesore parlamentare një avantazh të konsiderueshëm. Monitorimi mediatik i MVZ-së së ODIHR-it tregon se mbulimi mediatik i fushatës u përqendrua tek kryetarët e partive kombëtare dhe kandidatët për kryetar të Bashkisë së Tiranës, me vëmendje të kufizuar ndaj çështjeve të rëndësishme në nivel vendor. Kryesisht në programet e tyre të lajmeve, transmetuesit iu referuan atyre që dukeshin se ishin materiale partiake paraprakisht të regjistruara, rrallë të etiketuara, duke mos siguruar një mbulim gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës dhe debate thelbësore.

Kodi Zgjedhor parashikon rregulla të detajuara dhe garanci procedurale të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Ndërkohë që ankimimet mund të parashtrihen nga garuesit, interesat ligjore të të cilëve janë prekur, burimet ligjore të zgjedhësve dhe vëzhguesve janë të kufizuara. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) i KQZ-së i trajtoi ankimimet në mënyrë kolegjiale dhe në seanca të hapura; megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dyshim paanshmërinë e anëtarëve të KAS-it për shkak të përkatësisë së tyre politike. Kolegji Zgjedhor gjykoj ankimet në seanca publike, me pjesëmarrjen e palëve të përfshira.

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor nga vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë. Mund të vëzhgojnë edhe përfaqësues të partive, koalicioneve dhe kandidatëve të pavarur. Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi gjithsej 443 qytetarë dhe 407 vëzhgues ndërkombëtarë. Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, vetëm vëzhguesit e partive mund të marrin kopje të protokolleve të rezultateve. Disa organizata të shoqërisë civile monitoruan përdorimin e burimeve administrative ose shkeljet e rregullave të fushatës.

Dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishte paqësore, por u ndikua negativisht nga raste të shumta ndërhyrjesh të partive në proces, si dhe nga probleme teknike dhe procedurale. Vëzhguesit e MNVZ-së vlerësuan negativisht procesin e hapjes në një numër të madh të qendrave të votimit të vëzhguara. Votimi u vlerësua negativisht në 7 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, me raste tensionesh dhe raportim për vënien nën presion të votuesve. Në përgjithësi, procedurat e votimit u respektuan, por vëzhguesit e MNVZ-së, gjithashtu, raportuan raste të shkeljeve, veçanërisht raste të shumta të votimit në grup dhe disa probleme me fshehtësinë e votës. Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në 127 nga 144 raportet e paraqitura nga 60 QNV. Në shumicën e rasteve u cilësua si i ngadaltë, por profesional dhe metodik. Procedurat u ndoqën, por u vërejtën raste të izoluara tensioni dhe ndërhyrjeje nga aktivistët e partive. KQZ-ja publikoi një pjesëmarrje prej 36.3 përqind të zgjedhësve të regjistruar në votime, përfshirë dhe ata me banim jashtë vendit.

GJETJET PARAPRAKE

Sfondi dhe konteksti politik

Shqipëria është një Republikë Parlamentare, me kompetenca legjislativë që i janë dhënë një parlamenti njëdhomësh. Qeveria, e drejtuar nga kryeministri, ushtron kompetenca të gjera ekzekutive.

Zgjedhjet më të fundit vendore u zhvilluan në vitin 2019, në të cilat një koalicion i udhëhequr nga Partia Socialiste (PS) në pushtet fitoi 60 nga 61 bashkitë. Kandidati i Partisë Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen (MEGA) u zgjodh kryetar i bashkisë Finiq (qarku Vlorë).¹ Partia Demokratike (PD) e opozitës, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI; që nga ajo kohë u riquajt Partia e Lirisë (PL), e drejtuar nga ish-presidenti Ilir Meta) dhe disa parti më të vogla, bojkotuan zgjedhjet. Më 6 mars 2022, u mbajtën zgjedhje të pjesshme në gjashtë bashki, që kishin mbetur pa kryetar bashkie.²

¹ Kushtetuta parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Janë nëntë pakica kombëtare të njohura zyrtarisht: pakicat arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

² Zgjedhje të pjesshme u mbajtën në Dibër, Durrës, Lushnjë, Rrogozhinë, Shkodër dhe Vlorë. Komisioni i Rithemelimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë (KRPD) i udhëhequr nga Sali Berisha, i cili kandidonte me koalicionin “Shtëpia e Lirisë” fitoi në Shkodër, ndërkohë që PS-ja mbajti pesë pozicionet e tjera për kryetar bashkie.

PS-ja fitoi edhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, me 74 nga 140 vendet në parlament.³ Edi Rama e ruajti postin e kryeministrit për një mandat të tretë, duke filluar që nga viti 2013.⁴ Mjedisi politik vazhdon të jetë i karakterizuar nga dominimi i elitave politike tradicionale dhe polarizimi i thellë mes partive të mëdha. Kjo, e shoqëruar nga një ndarje e brendshme dhe mosmarrëveshje për përfaqësimin ligjor brenda PD-së, ka ndikuar në punën e parlamentit, përfshirë dhe reformën zgjedhore.⁵

Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor

Zgjedhjet vendore rregullohen kryesisht nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor (të dyja u ndryshuan për herë të fundit në vitin 2020) dhe nga ligje dhe rregullore të tjera përkatëse.⁶

Kuadri ligjor për zgjedhjet ofron një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, por përmban kufizime për të drejtat e votës, që nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe disa mospërputhje dhe paqartësi të shkaktuara nga ndryshimet ligjore të vitit 2020.⁷ Përveç kësaj, disa dispozita që lidhen me administrimin e zgjedhjeve, regjistrimin e kandidatëve, financimin e fushatës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të zgjedhjeve nuk janë në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare.

Dispozitat e paraqitura nga ndryshimet ligjore të vitit 2020, duke përfshirë ato që lidhen me administrimin zgjedhor, rregullat e fushatës dhe të financimit të fushatës, si dhe masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike, u zbatuan për herë të parë në zgjedhjet vendore. Këto ndryshime adresuan një sërë rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it, duke përfshirë ato për masat mbrojtëse kundër abuzimit me burimet publike dhe rritjen garancitë për balancën gjinore në listat e kandidatëve. Megjithatë, mungesa e një ndalimi për palët e treta për të bërë fushatë, politizimi i komisioneve të niveleve më të ulëta dhe dispozitat e paqarta mbi detyrimin për të raportuar aktivitetet publike nga bashkitë, lënë hapësira që kufizojnë qëndrueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e kuadrit ligjor. Miratimi me vonesë dhe publikimi i vonuar i disa akteve detyruese çënoi transparencën në proces dhe uli mundësinë e palëve të interesuara dhe zgjedhësve për t'u njohur në kohën e duhur me rregullat e procesit zgjedhor.⁸

³ Aleanca për Ndryshim e udhëhequr nga PD-ja fitoi 59 mandate; LSI - 4 mandate; dhe Partia Socialdemokrate (PSD) -3 mandate.

⁴ Trembëdhjetë nga 17 ministrat në qeverinë aktuale janë femra. Nga 140 anëtarë të parlamentit, 50 (nga 36 që kanë qenë më parë) janë femra (35 për qind), duke përfshirë edhe kryetaren.

⁵ Pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe shpalljes *persona non grata* nga qeveria e SHBA-së e ish-kryeministrit, dhe kryetarit të PD-së për një kohë të gjatë, z. Sali Berisha, PD-ja ka pësuar një ndarje të brendshme të trazuar, duke përfshirë mosmarrëveshjen për përfaqësimin e saj ligjor mes grupeve të drejtuara nga z. Berisha dhe Lulzim Basha, i cili drejtoi partinë nga viti 2013 deri në vitin 2022. Pas humbjes së PD-së në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të marsit të vitit 2022, z. Basha dha dorëheqjen si kryetar partie dhe Enkelejd Alibeaj, kryetari i grupit parlamentar të PD-së, ushtroi detyrën e kryetarit të PD-së. Më 3 mars 2023, një vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë në fuqi, ia la përfaqësimin ligjor të partisë z. Alibeaj. Z. Berisha dhe Komisioni i Rithemelimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë (KRPD) kanë njoftuar se do ta apelojnë atë vendim.

⁶ Legjislacioni dytësor përfshin Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Tubimet, Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave të zgjedhur, të emëruar ose që ushtrojnë funksione publike (Ligji për Dekriminalizimin), si dhe rregulloret e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Shqipëria është palë e traktateve kryesore ndërkombëtare që lidhen me zgjedhjet demokratike dhe është anëtare e Komisionit për Demokracinë të Këshillit të Evropës nëpërmjet Ligjit (Komisioni i Venecias) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

⁷ Për shembull, neni 145.2 i Kodit Zgjedhor i referohet versionit më të hershëm të nenit 24, i cili u shfuqizua me ndryshimet e korrikut të vitit 2020; kufizimi i të drejtës së votimit të personave me paaftësi intelektuale ose psikosociale u hoq nga neni 44, por mbeti në Kushtetutë (neni 45) dhe në nenin 53 të Kodit Zgjedhor. Kodi Zgjedhor, gjithashtu nuk është i harmonizuar me Ligjin për Dekriminalizimin, veçanërisht në lidhje me kufizimet e të drejtës së votës.

⁸ Për shembull, vendimi i KQZ-së i datës 6 maj, për raportimin financiar online, vendimi i KQZ-së i datës 22 prill, për përcaktimin e shumës së fondeve nga buxheti i shtetit për partitë politike që gëzojnë të drejtën e garës dhe Vendimi nr.30, i Kuvendit për miratimin e fondeve të fushatës për partitë politike i datës 26 prill.

Shumë rekomandime të mëparshme të ODIHR-it dhe Kongresit të Këshillit të Europës për Autoritetet Vendore dhe Rajonale mbeten të paadresuara, përfshirë ato që kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve më të ulëta, mekanizmin e tërheqjes së kandidatëve, të drejtat e votimit të personave me paaftësi intelektuale ose psikosociale, përgjegjësinë penale për shpifje, përdorimin e materialeve të fushatës të përgatitur nga partitë politike në lajme dhe të drejtat e barabarta të vëzhguesve partiakë dhe qytetarë. Në shkurt të vitit 2022, Parlamenti ngriti një komision *ad hoc* për reformën zgjedhore për të ndjekur rekomandimet e pazbatuara të ODIHR-it. Megjithatë, komisioni nuk ka propozuar asnjë ndryshim.

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor, të cilat u kundërshtuan përpara Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor) dhe u interpretuan nga ky i fundit, siguruan mbrojtjen e të drejtës së votës dhe kontribuan në sigurinë juridike.⁹ Nga ana tjetër, interpretimi i ngushtë i ligjit ishte i dukshëm në disa vendime të KQZ-së, duke sjellë paqartësi se si duhet të zbatohen disa dispozita.

Kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiakë zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetarë bashkie zgjidhen ata që kanë marrë numrin më të madh të votave, ndërsa këshilltarët zgjidhen sipas një sistemi proporcional me lista të mbyllura.

Administrata Zgjedhore

Zgjedhjet u administruan nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5,212 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Numërimi kryhet nga Grupet e Numërimit (GN) në 92 Qendra të Numërimit të Votave (QNV). Të gjitha komisionet e nivelit të ulët janë organe të përkohshme. Femrat janë të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse.¹⁰

Pas ndryshimeve të vitit 2020, KQZ-ja përbëhet nga tre organe të veçanta drejtuese: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) dhe Zëvendës Komisioneri, Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni për Ankimime dhe Sanksione (KAS). KQZ-ja është përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe anëtarët e saj zgjidhen nga Parlamenti.¹¹

Në përgjithësi, KQZ-ja ka funksionuar me efikasitet dhe ka përmbushur shumicën e afateve ligjore.¹² Komisioneri, Rregullatori dhe KAS mbajtën veçmas seanca të rregullta dhe të hapura, të cilat u transmetuan drejtpërdrejt në internet. MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se ndërhyrjet e përfaqësuesve të partive në seancat e KQZ-së, nuk ishin gjithmonë në dobi të përgatitjeve për zgjedhjet.¹³ Vendimet e KQZ-së publikohen përgjithësisht në faqen e saj të internetit; megjithatë, MVZ-ja e ODIHR-it vërejti vonesa në shpalljen e seancave dhe publikimin e vendimeve nga të treja organet, gjë që e kufizoi

⁹ Në rastin e Nismës Hashtag/Kosta Garo kundër KQZ-së, Kolegji Zgjedhor më 13 prill 2023 vendosi se mosregjistrimi i kandidatit për shkak të pretendimit të mungesës së dokumentacionit ishte në kundërshtim me parimin kushtetues të pluralizmit dhe të drejtën për t'u zgjedhur.

¹⁰ Megjithëse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind për të gjitha organet e administrimit zgjedhor, vetëm tre nga 12 anëtarët e KQZ-së janë femra, duke përfshirë edhe nënkomisionerin. Rreth 29 për qind e anëtarëve të KZAZ-së ishin gra, duke përfshirë 19 nga 92 kryetarët.

¹¹ Komisioneri drejton administratën e KQZ-së dhe ushtron kompetenca ekzekutive; Nënkomisioneri mbikqyr rekrutimin dhe trajnimin e anëtarëve të administratës zgjedhore dhe zbatimin e sistemit elektronik për identifikimin e zgjedhësve. Rregullatori nxjerr akte nënligjore dhe udhëzime të tjera normative, ndërsa KAS-ja shqyrton ankimet kundër Komisionerit, KZAZ-ve ose Rregullatorit.

¹² MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa vonesa në ndarjen e kohës së transmetimit falas për subjektet zgjedhore, në përcaktimin e renditjes së subjekteve në fletëvotim, emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GV-ve dhe publikimin e listave të zgjedhësve.

¹³ Për shembull, vendimi sipas të cilit partitë kanë të drejtë të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit u shty të paktën katër herë, për shkak të kërkesave të përfaqësuesve të partive.

transparencën.¹⁴ Ndërkohë që shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim tek KQZ-ja dhe vunë re më tepër hapje dhe transparencë në vendimmarrjen e saj, disa të tjerë vunë në pikëpyetje paanshmërinë e KAS-së dhe shkallën në të cilën të treja organet funksionojnë në mënyrë kolegjiale.

KZAZ-të parashikojnë zgjedhjet në zonat e tyre zgjedhore përkatëse. Ato përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote, i propozuar nga shumica parlamentare dhe opozita.¹⁵ KQV-të organizojnë votimin dhe përbëhen në të njëjtën mënyrë si KZAZ-të.

Formimi i komisioneve të niveleve më të ulëta ishte problematik, kryesisht për shkak të mospërbushjes nga ana e partive me të drejtë gare, të përgjegjësive të tyre, për të siguruar një administratë zgjedhore funksionale. Brenda afatit ligjor, KQZ-ja formoi KZAZ-të me vetëm katër ose pesë anëtarë dhe shpesh pa sekretar.¹⁶ Sipas ligjit, KQZ-ja mund të kërkonte aplikime nga qytetarët e kualifikuar për të përfunduar krijimin e KZAZ-ve; megjithatë, KQZ-ja priti vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë në lidhje me mosmarrëveshjen për përfaqësimin ligjor të PD-së, përpara se të emëronte anëtarët e KZAZ-së të propozuar nga PD-ja. Në 84 KZAZ, anëtarët e propozuar nga PD-ja u emëruan me një muaj vonesë.¹⁷ Në mënyrë të ngjashme, KQV-të do të krijoheshin deri më 24 prill, megjithatë, për shkak të propozimeve të vonuara dhe mungesës së dokumentacionit, shumica e KQV-ve u krijuan me një javë vonesë. Grupet e numërimit duhej të propozoheshin deri më 4 maj, por vendimi i Komisionerit për partitë me të drejtë gare, që kishin të drejtë të propozonin anëtarë të grupit të numërimit u apelua, gjë që çoi në krijimin me vonesë të tyre.¹⁸

Ndryshe nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe praktikat e mira ndërkombëtare, partitë politike ende mund të tërheqin ose zëvendësojnë anëtarët e tyre të komisionit sipas gjykimit të tyre dhe pa arsyetim, duke ndikuar kështu në stabilitetin e administratës zgjedhore.¹⁹ Nga data 12 shkurt dhe deri më 11 maj, rreth 38 për qind e KZAZ-ve u zëvendësuan, për shkak të tërheqjeve, mungesës së dokumentacionit ose dorëheqjeve.²⁰ Disa parti informuan vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, se ata planifikonin të zëvendësonin të gjithë anëtarët e tyre të KQV-së, për të shmangur presionin ose ryshfetet nga kundërshtarët e tyre. Prandaj, shumë nga propozimet fillestare të partisë ishin me natyrë formale, gjë që potencialisht sfidonte efikasitetin e administratës zgjedhore. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, deklaruan gjithashtu, se komisionet e niveleve më të ulëta mbeten të pambrojtura ndaj presionit politik dhe nuk gëzojnë ende besim të plotë.

KQZ-ja udhëhoqi një fushatë të gjerë për informimin e zgjedhësve, duke përfshirë një zhvillim të tillë në tetë gjuhë të pakicave dhe në gjuhën kombëtare të shenjave.²¹ Megjithatë, disa bashkëbisedues të

¹⁴ Në disa raste, KQZ-ja i publikoi vendimet me një javë ose më shumë vonesë. Disa njoftime për seancat janë dorëzuar në ditën e mbajtjes së seancave ose fare. Sipas KQZ-së, për shkak të problemeve me migrimin e faqes në një server më të sigurt më datë 25 prill, KQZ-ja nuk mundi të publikonte njoftimet apo vendimet në kohën e duhur deri më 6 maj.

¹⁵ KZAZ-të përbëhen nga 2 anëtarë të PS-së, 2 të PD-së, 1 të PSD-së dhe 1 anëtar të propozuar nga PL-ja. Në KZAZ-të me numra çift, anëtari i shtatë propozohet nga PS-ja, në ato me numra tek nga PD-ja. Kryetari i përket partisë që ka propozuar anëtarin e shtatë, ndërsa zëvendëskryetari dhe sekretari përfaqësojnë partinë tjetër.

¹⁶ Partitë duhej të paraqisnin propozime në mënyrë që KZAZ-të të krijoheshin brenda datës 12 shkurt.

¹⁷ Pas vendimit të gjykatës, më 10 mars 2023 u emëruan 217 anëtarë të KZAZ-së të propozuar nga PD-ja dhe më 21 mars 2023, 33 anëtarë shtesë. Këtu u përfshi edhe emërimi i sekretarëve në 42 KZAZ. Në disa raste, vendet vakante për sekretarë u plotësuan nga PL-ja.

¹⁸ Pas një ankese të koalicionit “Bashkë fitojmë” kundër vendimit të Komisionerit se cila parti ka të drejtë të propozojë anëtarët e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit, KAS-ja nuk mundi të merrte një vendim, për shkak të një votimi të ndarë midis katër anëtarëve të pranishëm.

¹⁹ Seksioni II.3.1 .f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) të vitit 2002 përcakton se “organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të lejohen t’i shkarkojnë ata sipas dëshirës”.

²⁰ Për të adresuar qarkullimin e lartë, KQZ-ja zhvilloi trajnime shtesë për anëtarët e KZAZ-ve.

²¹ Postera dhe spote mbi identifikimin e zgjedhësve dhe krimet zgjedhore u përgatitën gjithashtu në gjuhët e pakicave.

MVZ-së së ODIHR-it, vunë në dukje se materialet edukative lehtësisht të lexueshme nuk ishin të disponueshme dhe se përpjekjet e KQZ-së për informim nuk u përsëritën nëpër rajone. Edhe pse ligji parashikon që qendrat e votimit të jenë në ambiente të aksesueshme, aksesueshmëria dhe pjesëmarrja e zgjedhësve me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor mbetet një shqetësim.²²

Votimi elektronik pilot u zhvillua në 401 qendra votimi të bashkive Elbasan, Kamëz dhe Vorë, me 310,846 zgjedhës të regjistruar.²³ Zgjedhësit votuan duke përdorur pajisje me ekran me prekje (pajisje elektronike me regjistrim të drejtpërdrejtë), me një printer letre të gjurmëve të kontrollit, ku asnjëri prej të cilëve nuk është i lidhur me internetin. Zgjedhësit mund të verifikonin votën e tyre në një konfirmim të printuar nga një printer i lidhur me pajisjen. KQZ-ja, më 18 prill, filloi simulimet në tre bashkitë dhe një fushatë online për informimin e zgjedhësve.²⁴ KQZ-ja organizoi gjithashtu një testim publik të 3 përqind të pajisjeve, më datë 4 maj. Rezultatet paraprake u publikuan menjëherë pas mbylljes së votimit dhe do të bëhej një numërim manual i të gjitha konfirmimeve, pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve. Miratimi me vonesë i fondeve nga Parlamenti dhe shpërndarja e shumicës së mjeteve të votimit, vetëm dy muaj përpara zgjedhjeve, nuk lejoi informimin thelbësor të zgjedhësve ose auditimin e pavarur të pajisjeve të votimit.²⁵

Regjistrimi i Zgjedhësve

Qytetarët e moshës 18 vjeç e lart në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë, me përjashtim të atyre që konstatohen të paafte me vendim gjykatë, gjë që është në mospërputhje me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin bazuar në aftësinë e kufizuar.²⁶ E drejta e votës pezullohet edhe për shtetasit që vuajnë dënimin me burg për kryerjen e krimeve të caktuara.²⁷

Regjistrimi i zgjedhësve është pasiv dhe i decentralizuar, megjithatë zgjedhësit mbi 100 vjeç u hoqën automatikisht dhe duhej të konfirmonin të dhënat e tyre për ripërfshirje.²⁸ Zgjedhësit mund të kontrollonin të dhënat e tyre në regjistër dhe të kërkonin korrigjime deri më 4 prill 2023.²⁹ Listat

²² Neni 29(a) i [Konventës Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara \(CRPD\)](#) e vitit 2006 detyron shtetet që të sigurojnë se “procedurat, ambjentet dhe materialet e votimit janë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të lehta për t’u kuptuar”. Shikoni gjithashtu paragrafin 34 të [Komentit të përgjithshëm nr. 1 të nenit 12 të CRPD-së](#).

²³ Çdo qendër votimi ishte e pajisur me dy pajisje votimi. Në total, KQZ-ja ka prokuruar 828 pajisje elektronike votimi. Fletë votimi në letër ishin të disponueshme në KZAZ si rezervë, në rast mosfunksionimi të pajisjeve.

²⁴ Ndërkohë që demonstrimi i pajisjeve elektronike të votimit i ndihmoi zgjedhësit të njiheshin me mënyrën e re të votimit, zonat e thella rurale nuk kishin akses të barabartë në këto prezantime. Për më tepër, pajisjet demonstruese nuk ishin të pajisura me letër për printerin e mandateve, duke mos lejuar zgjedhësit të simulonin të gjitha fazat e procesit të votimit.

²⁵ [Udhëzimet e Këshillit të Evropës për zbatimin e dispozitave të Rekomandimit CM/Rec \(2017\)5 mbi standardet e votimit elektronik theksojnë se](#) “Aksesi publik në komponentët e sistemit të votimit elektronik dhe informacioni mbi to, në veçanti dokumentacioni, kodi burimor dhe marrëveshjet e konfidencialitetit, duhet t’u ofrohen palëve të interesuara dhe publikut në përgjithësi, shumë më përpara periudhës zgjedhore”.

²⁶ Neni 29 i CRPD-së kërkon që Shtetet Palë t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato njësoj si të tjerët”. Shikoni gjithashtu paragrafin 48 të [Komentit të Përgjithshëm nr. 1 të nenit 12 të KRPD-së](#). Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) parashikon që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së do të “garantojnë të drejtën e votës universale dhe të barabartë për qytetarët e rritur”.

²⁷ Ligji për Dekriminalizimin pezullon të drejtat e votës për kryerjen e krimeve të renditura në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke filluar nga veprat penale të lidhura me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

²⁸ Shikoni nenin 26 të [“Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike” të vitit 1996](#). Paragrafi 5.9 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) përcakton: “Të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtjen e barabartë nga ligji”. Sipas MB-së, nga 3,717 votues mbi 100 vjeç, 3,589 u hoqën nga regjistri i zgjedhësve dhe 128 mbeten në listën përfundimtare të zgjedhësve.

²⁹ Zgjedhësit mund të kontrollojnë të dhënat e listës së tyre të zgjedhësve duke përdorur aplikacionin e KQZ-së ose portalet online në e-albania.al. 237 zgjedhës kërkuar korrigjime të vogla dhe 34,184 ndryshuan vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit për shkak të ndryshimit të vendbanimit përpara se listat e zgjedhësve të mbylleshin më 4 prill. Zyrat e gjendjes civile përgatitën ekstrakte gjashtë mujore, duke filluar nga data 22 nëntor 2022. Pas datës 4 prill dhe deri në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, zgjedhësit mund të kërkonin ndryshime në të dhënat e tyre nëpërmjet gjykatës së rrethit.

përfundimtare të zgjedhësve përmbanin gjithsej 3,650,550 zgjedhës, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm zgjedhësish që jetojnë jashtë vendit, veçanërisht të rinj.³⁰ Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, përgjithësisht, shprehën besim në saktësinë e listave të zgjedhësve, por vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, vërejtën mospërputhje në shpërndarjen e njoftimeve të zgjedhësve nga autoritetet vendore dhe se ndonjëherë listat e zgjedhësve nuk ishin publikisht të shpallura në qendrat e votimit, gjë që kufizonte kontrollin publik të listave të zgjedhësve në ato zona.³¹ Garuesit mund të kërkonin kopje të listave të zgjedhësve për qëllime fushate.

Në janar të vitit 2023, MB-me ndryshoi udhëzimin fillestar, duke specifikuar kritere shtesë për caktimin e zgjedhësve në qendrat e votimit, sipas kodit të ndërtesës dhe alfabetikisht sipas mbiemrit.³² Ndërkohë, MVZ-ja e ODIHR-it u informua se këto ndryshime do të preknin vetëm zgjedhësit e caktuar në qendrat e votimit që në një moment u ndanë në “fraksione” dhe u ngritën shqetësime se kjo mund të çorientonte zgjedhësit në ditën e zgjedhjeve.

Identifikimi i zgjedhësve në ditën e zgjedhjeve u krye me pajisje elektronike të identifikimit offline që përmbanin listat e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit paraqitën karta identiteti ose pasaporta biometrike për të verifikuar identitetin e tyre dhe gjurmët e gishtave u skanuan, për të konfirmuar se ata ishin identifikuar.³³ Pasi identifikohesh me sukses, një konfirmim me të dhënat personale dhe një fotografi printohesh dhe ruhej nga KQV-të për verifikimin paszgjedhor. Rekrutimi i operatorëve teknikë për identifikimin e zgjedhësve ishte një sfidë për administratën zgjedhore në disa zona dhe KQZ-së iu desh t’i zhvillonte vonë trajnimet, deri afër ditës së zgjedhjeve. Trajnimet e vëzhguara u vlerësuan pozitivisht nga vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it.

Regjistrimi i Kandidatëve

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të garojë, me përjashtim të atyre që vuajnë dënimin me burg ose të dënuar paraprakisht për disa kategori të caktuara krimesh ose janë në kërkim, si dhe ata që mbajnë poste publike, të cilat janë të papajtueshme me statusin e kandidatit.³⁴ Kufizimet ekzistuese për të drejtën e kandidimit, në rastet e çështjeve pa një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.³⁵

³⁰ Sipas raportit të vitit 2020 nga [Instituti Shqiptar i Statistikave](#), rreth 1.6 milionë shtetas shqiptarë banojnë jashtë vendit. Listat përfundimtare të zgjedhësve përfshijnë 1,843,170 zgjedhës meshkuj dhe 1,807,380 femra.

³¹ Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it vërejtën se në Cërrik, në disa zona të Kukësit, në Shkodër dhe në Tiranë listat e zgjedhësve nuk ishin afishuar në kohë. - Në Kukës dhe në disa zona të thella të qarkut të Elbasanit, listat e zgjedhësve u dëmtuan ose u hoqën ose u vendosën në një mënyrë që nuk lejonte leximin nga ana e publikut.

³² Kryetarët e bashkive, në bashkërendim me zyrtarë vendore të gjendjes civile, duhej të gruponin votuesit sipas kufijve të qendrave të votimit, duke u siguruar që qendrat e votimit ose “fraksionet” e qendrave të votimit të kenë jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës të regjistruar. Sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, për këtë ndryshim ka pasur konsultime paraprake me KQZ-në dhe partitë politike.

³³ KQZ-ja prezantoi kritere të reja për identifikimin e zgjedhësve, për të adresuar tentativat e mundshme për imitim. Zgjedhësit patën mundësi deri në tre përpjekje për gishtin e madh dhe tregues për t’u identifikuar. Nëse kjo dështonte, ata duhej të nënshkruanin në listën e zgjedhësve dhe printimin nga pajisja për t’u lejuar të votojnë. Sipas MB-së, pati 271,000 zgjedhës me ID të skaduar. Në mars, qeveria zgjati vlefshmërinë e dokumenteve të identifikimit të skaduar për të siguruar pjesëmarrjen e zgjedhësve të prekur.

³⁴ Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja ose Shtetet e Bashkuara. Ai gjithashtu i referohet qytetarëve të dënuar për krime të caktuara, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, si dhe ata që janë nën urdhër kërkimi ndërkombëtar. Gjyqtarët, prokurorët, oficerët ushtarakë, policorë dhe të sigurisë kombëtare, personeli diplomatik, prefektët, anëtarët e komisioneve zgjedhore, Presidenti i Republikës dhe zyrtarët e lartë të administratës shtetërore të përcaktuar me ligj, duhet të japin dorëheqjen që të kenë të drejtë të kandidojnë.

³⁵ Paragrafi 5.19 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) përcakton se “Çdokush do të prezumohet i pafajshëm derisa të provohet fajësia sipas ligjit.” Seksioni I 1.1 (d), iii i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) përcakton se “duhet respektuar parimi i proporcionalitetit; Kushtet për privimin e individëve nga drejta për t’u zgjedhur mund të jenë më pak të rrepta se sa për heqjen e të drejtës së tyre për votim”.

KQZ-ja regjistroi gjithsej 40 parti dhe koalicione si subjekte zgjedhore që kishin të drejtë të paraqisnin kandidatë.³⁶ Kandidatët e pavarur mund të propozohen nga grupe prej të paktën nëntë zgjedhësish me banim në bashkinë përkatëse. Për t'u regjistruar, listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë duhej të përfaqësonin në mënyrë të barabartë meshkujt dhe femrat, me kandidatë të gjinive të ndryshme të alternuara në listë. Ky kriter nuk u zbatua në disa bashki.³⁷ Përveç kësaj, partive dhe grupeve të zgjedhësve iu kërkua të dorëzonin nënshkrime mbështetëse të jo më pak se 1 për qind të zgjedhësve nga bashkia përkatëse, përveçse nëse ata kishin qenë të përfaqësuar në Parlament ose në pushtetin lokal për një periudhë të paktën gjashtëmuajore.

Megjithatë, në disa raste, kandidatët e pavarur dhe disa parti hasën vështirësi në regjistrimin e tyre.³⁸ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it nga partitë më të vogla politike konsideruan se kriteret për dokumentacion, në mbështetje të listave të kandidatëve, ishin tepër të vështira.³⁹ Mbledhja e nënshkrimeve të mbështetjes prej 1 për qind, pavarësisht nga madhësia e bashkisë, ishte më e vështirë për kandidatët e pavarur sesa për partitë politike, veçanërisht në Tiranë dhe në Durrës.⁴⁰

Kandidaturat u verifikuan në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Dekriminalizimin.⁴¹ Dyzet e tre kandidatë ishin nën shqyrtim, deri në ditën e zgjedhjeve, nga Prokurori i Përgjithshëm, dhe mbeti e paqartë deri në ditën e zgjedhjeve, nëse ata kishin të drejtë të kandidonin.

Në një proces kryesisht gjithëpërfshirës, administrata zgjedhore regjistroi gjithsej 144 kandidatë për kryetarë bashkie, duke përfshirë 15 femra dhe 23,763 kandidatë për këshilltarë për 61 pozicione kryetar bashkie dhe 1,603 për pozicion këshilltar. Dy kandidatë të pavarur ishin kandidatë për kryetar bashkie dhe dhjetë për këshilltarë.⁴² PS-ja dhe koalicioni “Bashkë fitojmë”, ishin dy subjektet e vetme zgjedhore që propozuan kandidatë në pothuajse të gjitha bashkitë për të dyja

³⁶ Subjektet zgjedhore duhej të dorëzonin listat e kandidatëve në KZAZ-të përkatëse ose në KQZ, jo më vonë se data 25 mars. Bashkitë me më shumë se 80,000 zgjedhës të regjistruar ndahen nga KQZ-ja në më shumë se një zonë zgjedhore. Për këto zgjedhje, 50 nga 92 KZAZ-të janë në përputhje me bashkinë përkatëse dhe kanë bërë regjistrimin e kandidatëve. Për 11 bashkitë e mbetura, regjistrimi i kandidatëve u menaxhua nga KQZ-ja. Një kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë dhe renditja në listat e kandidatëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit.

³⁷ MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje se disa lista kandidatësh në 55 bashki nuk përmbushnin kërkesat për kuotën gjinore. Për shembull, në Kukës, tetë lista nuk përmbushnin kërkesën me disa lista që kishin gjashtë kandidatë meshkuj më shumë se femra, duke rezultuar në gjithsej 37 kandidate femra më pak. Në Kuqovc, nëntë lista nuk e kanë respektuar kuotën gjinore. Në Librazhd dhe Tropojë - shtatë lista. Divjakë, Klos, Kelcyrë, Kurbin, Malësi e Madhe, Selenicë, - nga pesë lista në çdo bashki nuk plotësonin kërkesën; dhe në Bulqizë, Fushe-Arrez, Gjirokastra, Has, Kruje, Permet, and Pustec nga katër lista në çdo bashki nuk plotësonin kuotën e gjinisë. Gjithashtu, disa nga listat nuk ishin në përputhje me numrin e caktuar të kandidatëve për listë të përcaktuara me Vendimin nr. 100 të Komisionerit.

³⁸ “Lëvizja Bashkë”, e cila paraqiti kandidatë për kryetarë bashkie dhe këshilltarë në Tiranë, u regjistrua si parti politike nga Gjykata e Tiranës me vonesë, më 2 mars. Komisioneri dhe KAS-ja e cilësuan vendimin e gjykatës si jo të formës së prerë dhe refuzuan regjistrimin e partisë si subjekt zgjedhor. Ky vendim u rrëzua nga Kolegji Zgjedhor, i cili urdhëroi KQZ-në të regjistronte “Lëvizjen Bashkë” si subjekt zgjedhor. Më 18 prill 2023, KQZ-ja rivendosi në detyrë kandidatin për kryetar bashkie të Nismës Hashtag në Dropull (qarku Gjirokastrë), pas një vendimi të Kolegjit Zgjedhor katër ditë pas fillimit të fushatës.

³⁹ Partitë duhet të dorëzojnë kopje të nënshkruara të ID-ve të zgjedhësve që kanë nënshkruar në mbështetje të tyre.

⁴⁰ Në rastin e Tiranës, pragu për nënshkrime u përcaktua 7000 zgjedhës, në kundërshtim me parashikimet për partitë politike jo më pak se 50 dhe maksimumi 3000 për zgjedhjet vendore. Sipas ligjit, administrata zgjedhore verifikon 5 për qind të nënshkrimeve të dorëzuara.

⁴¹ KQZ-ja dhe 50 KZAZ-ë verifikojnë që kandidatët kanë të drejtë të kandidojnë dhe KQZ-ja verifikon që kandidatët plotësojnë kriteret e integritetit të përcaktuara nga ligji, pra që nuk janë dënuar ose janë nën hetim për vepra të caktuara penale. Nëse kërkohet hetim i mëtejshëm, ata i referojnë kandidatët në Prokurorinë e Përgjithshme.

⁴² Në bazë të të dhënave të KQZ-së, tre partive dhe shtatë grupeve të zgjedhësve iu është refuzuar regjistrimi për shkak të dokumentacionit jo të plotë. Tre kandidatë për kryetar bashkie dhe 10 kandidatë për këshillin vendor u tërhoqën pasi u regjistruan.

garat.⁴³ Disa bashkëbisedues të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) shprehën keqardhje që përzgjedhja e kandidatëve përgjithësisht ishte bërë në nivel qendror dhe jo në nivel vendor.

Mjedisi i Fushatës

Periudha zyrtare 30-ditore e fushatës filloi më datë 14 prill dhe përfundoi një ditë para ditës së zgjedhjeve. Votuesve iu paraqit mundësi e shumëllojshme zgjedhjeje, me zgjedhje këshillash që kaluan në plan të dytë krahasuar me zgjedhjen e kryetarëve të bashkisë. Megjithatë, duke theksuar shqetësimin e grupeve të ndryshme të interesit për diversitetin e vërtetë politik, fushata u përqendrua rreth partive të mëdha, veçanërisht PS-së në pushtet dhe koalicionit “Bashkë fitojmë”. Koalicioni u drejtua nominalisht nga PL-ja, por dominohej nga KRPD-ja, e cila nuk kishte statusin formal të një partie koalicioni, por paraqiti shumicën e kandidatëve të koalicionit.

Përgjithësisht, liritë themelore të tubimit dhe të shprehjes u respektuan dhe subjektet zgjedhore mundën ta bënin fushatën lirshëm.⁴⁴ Megjithatë, bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it në disa rajone, pohuan se mbështetësit e opozitës u përballën me vënie nën presion, që synonin t’i pengonin ata të merrnin pjesë në aktivitete të fushatës.⁴⁵ Në të njëjtën kohë, MVZ-ja e ODIHR-it u informua për shumë raste, ku punonjësve të bashkisë u ishte thënë të mbështesnin ose të votonin për PS-në, ose ishin paralajmëruar të mos e mbështesnin opozitën.⁴⁶ Situata u ndërlikua nga disa pretendime për blerje votash ose dhënie stimulësh financiarë për zgjedhësit, që të mos merrnin pjesë në zgjedhje, në shumicën e rasteve të iniciuara nga PS-ja.⁴⁷

Më 12 maj, në Himarë (Qarku Vlorë), një kandidat për kryetar bashkie nga minoriteti grek i koalicionit “Bashkë fitojmë”, u ndalua me akuzën për blerje votash.⁴⁸

Fushata u drejtua nga personalitete, përgjithësisht nga kryetarët e partive kryesore, Edi Rama i PS-së dhe Sali Berisha i KRPD-së, të cilët u shfaqën rregullisht në të gjithë vendin. Përveç z. Rama, të gjithë ministrat e qeverisë, me përjashtim të njërit, morën pjesë në fushatën e PS-së, secili në çdo qark të vendit⁴⁹. Ndonëse me raste pati ndonjë diskurs specifik të nxitur nga çështjet vendore, drejtuesit udhëhoqën në mënyrë efikase një fushatë mbarëkombëtare, me PS-në që theksonte vazhdimin e progresit infrastrukturor dhe opozitën duke u fokusuar në çështjet e korrupsionit, keqmenaxhimit të fondeve publike dhe migracionit. Toni i gjuhës së përdorur në fushatë ishte kryesisht i moderuar.

⁴³ “Bashkë fitojmë” propozoi kandidatë për të dyja garat në të 61 bashkitë, PS-ja paraqiti 60 kandidatë për kryetar bashkie dhe 61 për zgjedhjet e këshillit. Dhjetë subjekte të tjera zgjedhore propozuan kandidatë për këshilltarë në të paktën gjysmën e bashkive (Partia Agrare Ambientaliste në të gjitha bashkitë). Në të njëjtën kohë, përveç “Bashkë fitojmë” dhe PS-së, edhe shtatë subjekte të tjera zgjedhore propozuan kandidatë për kryetar bashkie: PD në 15 bashki dhe gjashtë subjekte të tjera në nga një bashki secila. Nëntë kandidatë romë garuan në listat e këshillit të partive të ndryshme.

⁴⁴ MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni të dy rasteve të dhunës. Më datë 11 Prill, në Vaun e Dejës (Qarku i Shkodrës) është vendosur një bombë në makinën e një drejtuesi vendor të KRPD-së, duke shkaktuar dëme materiale. Më 19 prill, një drejtues vendor i PSD-së dhe një kandidat për këshilltar në Shëngjin (qarku Lezhë) u qëllua për vdekje në pronën e tij të biznesit. Policia njoftoi se nuk e konsideronte se vrasja kishte lidhje me zgjedhjet.

⁴⁵ Raportime të tilla janë marrë nga qarqet e Dibrës, Durrësit, Gjirokastrës dhe Shkodrës.

⁴⁶ MVZ-ja e ODIHR-it, mori raportime të tilla nga qarqet e Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës dhe Tiranës.

⁴⁷ Raportime të tilla janë marrë nga qarqet e Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Lezhës, Shkodrës dhe Tiranës.

⁴⁸ Para ndalimit, zoti Rama në një emision të televizionit Klan e kishte cilësuar kandidatin si “të pafytyrë”, “inJORANT”, “analfabet” që “angazhonte njerëz për të kërcënuar emigrantët”.

⁴⁹ Kryeministri nuk mori pjesë në katër seancat e fundit të qeverisë që nga 7 prilli. Seancat u mbajtën rregullisht çdo javë, megjithatë nuk pati asnjë seancë gjatë javës së kaluar të fushatës dhe e fundit u mbajt më 4 maj.

Megjithatë, një retorikë dhe stil kundërvënës, duke përfshirë tabelat dhe video spotet, u bënë më të shpeshta, ndërkohë që fushata po përparonte në kohë.⁵⁰

Në përgjithësi, fushata ishte e dukshme, por jo e bujshme. Ishte e dallueshme që në fillim, në Tiranë, ku MVZ-ja e ODIHR-it vërejti një prani të konsiderueshme të materialeve të fushatës në terren, të cilat promovonin partitë dhe jo kandidatët, ku mbizotëronte dukshëm PS-te.⁵¹ Disa bashkëbisedues informuan MNVZ-ve, se hapësira e përcaktuar për afishimin e materialeve zgjedhore ishte e pamjaftueshme, e cila e bëri zhvillimin e fushatës për kandidatët e rinj të vështirë.⁵² Garuesit kryesorë organizuan tubime më të mëdha në terren. Femrat kandidatë u shfaqën në shumicën e tubimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, megjithatë, pjesëmarrja e femrave në publik ishte relativisht e kufizuar.⁵³ Në përgjithësi, partitë garuese zhvilluan kryesisht takime në përmasa të vogla, vizita derë më derë, postera të vegjël dhe rrjete sociale.⁵⁴ Rrjetet sociale u konsideruan si mjete për fushatën, veçanërisht të përshtatshme dhe efektive, nga kandidatët që iu mungonin burimet financiare.

Më datë 24 mars, KRPD-ja kërkoi që Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar (SPAK) të fillonte hetimin penal në lidhje me shpërndarjen dhe përdorimin e aplikacionit “*Aktivisti*”, i cili u prezantua në vitin 2022 nga PS-ja. KRPD-ja pretendoi se aplikacioni përdoret brenda administratës të kontrolluar nga PS-ja, për të kontrolluar punonjësit e sektorit publik nën varësi, në mënyrë që ata të mbështesin në rrjetet sociale aktivitetet e PS-së, drejtuesve të saj dhe zyrtarëve të partisë. PS-ja ka mohuar pretendimet se aplikacioni përdoret për të kontrolluar punonjësit e sektorit publik. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it, në raste të ndryshme konfirmuan se aplikacioni ishte në përdorim nëpër bashki dhe perceptohej si një mjet për rritjen dhe promovimin e profilit të PS-së në rrjetet sociale. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, një promovim i tillë ishte shpesh pasojë e udhëzimeve nga eprorët e tyre të lidhur me PS-në.

Sipas ligjit, autoritetet nuk mund të propozojnë, të miratojnë ose të nxjerrin vendime për përfitime, katër muaj përpara ditës së zgjedhjeve dhe deri në formimin e një qeverie të re. Megjithatë, pati një sërë aktivitetesh, si nga pushteti qendror, ashtu edhe nga administrata të ndryshme vendore, të cilat u duk se ishin në kundërshtim me këtë kriter ligjor. Krahas vendimit të datës 31 mars për dhënien e një bonusi prej 5,000 lekësh (rreth 44 euro) për pensionistët, të paktën dhjetë vendime u miratuan nga qeveria në muajin prill, të cilat rritën pagat e kategorive të ndryshme të punonjësve të sektorit publik,

⁵⁰ Z. Berisha dhe z. Meta u portretizuan nga zoti Rama dhe PS-ja si mishërime të një të shkuare të errët, ndërsa KRPD-ja e etiketoi zotin Rama dhe ministrat e tij në skicat me *photoshop* si “mafia më e madhe në planet”.

⁵¹ Billbord-et dhe posterat shpesh nuk përmbanin informacionet identifikuese të kërkuara nga ligji. Komisioneri, më 3 maj, vendosi që materiali i tillë i fushatës duhet të hiqet nga policia deri më 5 maj.

⁵² Sipas ligjit, kryetarët e bashkive përcaktojnë hapësirat publike për afishimin e materialeve zgjedhore. MVZ-ja e ODIHR-it vërejti që, psh., në 3 nga 5 bashkitë në qarkun e Tiranës, përfshirë edhe Bashkinë e Tiranës, listat e hapësirave të përcaktuara nuk ishin të disponueshme në faqen e internetit të Bashkisë.

⁵³ Nga 65 aktivitete të fushatës, të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, 39 patën folëse femra. Në të njëjtën kohë, vlerësimet për pjesëmarrjen e femrave në publik, variuan në mënyrë të konsiderueshme nga 0 në 90 për qind, me një mesatare prej rreth 30 për qind. Asnjë bashkëbisedues i MVZ-së i ODIHR-it nuk shprehu shqetësime për retorikë mizogjene, kërcënime apo gjuhë urrejtjeje drejtuar politikaneve femra, apo ngacmime online ndaj femrave në kontekstin zgjedhor.

⁵⁴ Nga 44 parti politike garuese (38 parti që garojnë më vete dhe 6 parti brenda dy koalicioneve), vetëm 24 përdorën një llogari zyrtare në Facebook, ku PD-ja dhe PS-ja kanë numrin më të madh të ndjekësve, me rreth 328,000 dhe 204,000 ndjekës përkatësisht. Llogaritë në Facebook, të politikanëve janë shumë më të njohura (40 kryetarë kanë një llogari zyrtare në Facebook, z. Rama me 1.62 milionë dhe z. Berisha me 1.12 milionë ndjekës, me shifrat më të larta ndër politikanët) dhe gjatë fushatës kanë gjeneruar aktivitete më të larta. Ndër politikanët, z. Rama ka bërë 267 postime gjatë periudhës zyrtare të fushatës, (z. Berisha ishte më aktiv, me 331 postime) dhe gjeneroi numrin më të lartë të ndërveprimeve (2,23 milion), i ndjekur nga z. Berisha me 0,63 milion ndërveprime. Në të njëjtën kohë, një aktivitet i rëndësishëm fushate i disa kandidatëve për kryebashkiakë të Tiranës u vu re në Instagram (Z. Veliq nga PS-ja) ose Tik-Tok (Belind Kellici nga “Bashkë fitojmë”).

nga mësuesit të zjarrfikësit.⁵⁵ Gjithashtu, z. Rama, në disa raste, kushtëzoi mbështetjen e ardhshme të qeverisë ndaj bashkive, me rezultatet e zgjedhjeve.⁵⁶

Vëzhguesit e MVZ-së së ODIHR-it, vërejtën raste të shumta, në të cilat administratat vendore u angazhuan në aktivitete të ngjashme, duke përfshirë riparimet e infrastrukturës lokale, shpërndarjen e ushqimeve ose ofertat për punësim afatshkurtër, duke përfshirë edhe komunitetet e pakicave kombëtare.⁵⁷ Shpesh, nuk pati asnjë dallim të qartë ndërmjet veprimtarive zyrtare dhe atyre të fushatës. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, shprehën shqetësimin se asnjë veprim zyrtar nuk u ndërmor nga KQZ-ja pas këtyre lloj aktiviteteve, të cilat e përforconin më tej avantazhin e PS-së.⁵⁸ Komisioneri deklaroi publikisht se dispozita përkatëse e Kodit Zgjedhor (Neni 91.4) zbatohet vetëm për zgjedhjet parlamentare.⁵⁹ Një interpretim i tillë i ngushtë dhe formal, që pasqyron gërmën dhe jo frymën e ligjit vështirë se garanton të njëjtin nivel fushëloje.⁶⁰

Financimi i Fushatës

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor dhe Ligji për Partitë Politike. Ndryshimet ligjore të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor adresuan pjesërisht rekomandimin e mëparshëm të ODIHR-it, duke zgjeruar të drejtën e KQZ-së për të verifikuar drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës, por rekomandimet për raportimin e pjesshëm të financimit të fushatës dhe rregullimin e financave të palëve të treta mbeten të paadresuara. Përveç kësaj, kufiri në shpenzimet e fushatës u ul ndjeshëm⁶¹.

Garuesit mund të financojnë fushatat e tyre nga fondet publike dhe private.⁶² Partitë politike që kanë marrë të paktën 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit vendore, gëzojnë të drejtën për financim publik shtesë për fushatën e tyre. Kuvendi caktoi 100 milionë lekë për fushatën e zgjedhjeve vendore.⁶³ Megjithatë, PD-ja ka informuar MVZ-në e ODIHR-it, se një javë para zgjedhjeve nuk kanë marrë ende fonde nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me ligjin.⁶⁴ Subjektet zgjedhore që nuk

⁵⁵ 1 euro është afërsisht 110 lekë.

⁵⁶ Më 22 prill në Kamëz, teksa iu referua në mënyrë nënçmuese kandidatit të KRPD-së, z. Rama tha se “Kush do fusë gomarin me veshë të gjata në Bashki, ta harrojë qeverinë. Ta harrojë mbështetjen nga qeveria.” Në një postim në Facebook të datës 23 prill, zoti Rama prezantoi një projekt që do të zhvillohet në Shkodër dhe financohet plotësisht nga qeveria shqiptare dhe [komentoi](#) se: “Ky është një nga projektet transformuese për Shkodrën, fati i të cilit është i lidhur fort me vullnetin e komunitetit të Shkodrës më 14 maj.” Më 2 maj, KRPD-ja depozitoi një ankesë në SPAK, duke kërkuar një hetim penal në lidhje me deklaratat e tilla të bëra nga zoti Rama gjatë gjithë fushatës dhe të konsideruara nga KRPD-ja si kërcënime.

⁵⁷ Raste të tilla janë shënuar në të gjitha qarqet.

⁵⁸ Në të njëjtën kohë, KAS sanksionoi të paktën 16 kryetarë bashkish me një gjobë maksimale prej 100,000 Lekësh (afërsisht 910 Euro), secila për fushatë të paligjshme në favor të PS, në faqen zyrtare bashkisë dhe/ose të kryetarit të bashkisë në Facebook.

⁵⁹ Komisioneri e bëri këtë [deklaratë](#) gjatë një konference për shtyp më 30 mars.

⁶⁰ Neni 91 i Kodit Zgjedhor (Ndalimi i përdorimit të burimeve publike për mbështetjen e subjekteve zgjedhore), nuk synon të përcaktojë ndalime vetëm në lidhje me zgjedhjet parlamentare. Vendimi nr. 9 i Rregullatorit i muajit dhjetor të vitit 2020, i miratuar me qëllimin për të kufizuar abuzimin e mundshëm me burimet administrative, në nenin 1 të tij përcakton se “[që] qëllimi [...] është vendosja e rregullave për marrjen e masave, monitorimin dhe parandalimin e aktiviteteve, sjelljeve të ndaluara, ose përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, me qëllim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe Partive politike [...]”

⁶¹ Kufiri i dhurimeve nga fondet private që duhet të mbahen në llogarinë e posaçme bankare të një subjekti zgjedhor është ulur nga 100 000 lekë (rreth 900 euro) në 50 000 lekë (afërsisht 450 euro).

⁶² Më 12 prill, KQZ-ja shpërndau 345,341,079 lekë (afërsisht 3,07 milionë euro) fonde publike vjetore për 11 parti.

⁶³ KQZ-ja vendosi më 22 prill, tetë ditë pas fillimit të fushatës, shpërndarjen e rreth 97 milionë lekëve (rreth 872 mijë euro) për 13 subjekte zgjedhore. Vendimi i parlamentit për ndarjen e fondeve u publikua vetëm më date 26 prill.

⁶⁴ Neni 88.6 i Kodit Zgjedhor parashikon që fondet e alokuara për partitë politike të shpërndahen jo më vonë se pesë ditë pas periudhës së regjistrimit të kandidatëve, p.sh. 9 prill.

kualifikohen për financim publik kompensohen pas zgjedhjeve.⁶⁵ Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë për financim publik, në mospërputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁶⁶

Fondet private mund të përfshijnë mjetet e vetë garuesve, donacione nga shtetas dhe persona juridikë shqiptarë, si dhe kredi bankare. Donacionet individuale, përfshirë në natyrë, janë të kufizuara në 1 milion lekë (afërsisht 8,850).⁶⁷ Sipas KQZ-së, ky kufi vlen edhe për subjektet zgjedhore që dëshirojnë të financojnë fushatën nga burimet e tyre. Megjithatë, nuk ka asnjë kufizim në shumën totale të donacioneve që një kandidat ose parti mund të pranojë.

Shpenzimet totale për fushatën e një partie ose koalicioni kufizohen në 300 për qind dhe ato të një kandidati të pavarur 50 për qind të shumës më të lartë të fondeve publike të akorduara për një parti, bazuar në rezultatet e zgjedhjeve vendore të fundit. Gjithsesi, kufiri për shpenzimet e fushatës varet drejtpërdrejt nga diskrecioni i institucioneve shtetërore që përcaktojnë shumën e financimit publik.⁶⁸

KQZ-ja mbikëqyr pajtueshmërinë me rregullat e financimit të fushatës. Ligji parashikon një gamë të gjerë sanksionesh kundrejt shkeljeve të financimit të fushatës, duke përfshirë gjobat dhe konfiskimin e fondeve. KQZ-ja asistohet nga 119 monitorues të fushatës, por MVZ-ja e ODIHR-it, vërejt se raportet e tyre periodike nuk përmbajnë informacion thelbësor mbi financimin e fushatës.⁶⁹

KQZ-ja nxori udhëzime mbi rregullat për raportimin financiar dhe kontrollin dhe verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës së garuesve më 7 prill dhe miratoi udhëzimet mbi raportimin financiar për garuesit më 20 prill. Miratimi me vonesë i rregullave dhe udhëzimeve ka cënuar sigurinë juridike, duke marrë në konsideratë se periudha e llogaritjes së të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës është nga data e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

Garuesit duhet të dorëzojnë raporte financiare brenda 60 ditësh nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve.⁷⁰ KQZ-ja duhet të caktojë audituesit për të analizuar këto raporte financiare dhe për të publikuar raportet e audituesve 30 ditë pas dorëzimit të tyre. Nuk ka asnjë kriter për raportim të ndërmjetëm të financimit të fushatës, as raportim vjetor përpara zgjedhjeve, duke cënuar

⁶⁵ Sipas nenit 89 të Kodit Zgjedhor, për t'u kualifikuar për kompensim, një subjekt zgjedhor duhet të marrë jo më pak se një për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.

⁶⁶ Paragrafi 185 i Udhëzimeve të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias [Për rregullimin e partive politike \(botimi i dytë\)](#) përcakton: "Kur partive politike u sigurohet mbështetje shtetërore, si sigurimi i kohës së transmetimit në media publike ose financimi i fushatës, duhet të ketë gjithashtu një sistem mbështetjeje për kandidatët e pavarur për të siguruar që atyre u jepet trajtim i barabartë në shpërndarjen e burimeve shtetërore."

⁶⁷ Personat juridikë që kanë marrë fonde prokurimi publik mbi 10 milionë lekë (afërsisht 89 800 euro), ata që janë përfshirë në projekte të partneritetit publik ose kanë borxhe ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ata që ushtrojnë veprimtari në lidhje me median, nuk janë lejohet të dhurojnë për fushatat elektorale.

⁶⁸ Shikoni paragrafin 248 të Udhëzimeve të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias [Për rregullimin e partive politike \(botimi i dytë\)](#): "Cilido sistem të miratohet, kufijtë e tillë duhet të përcaktohen qartë në ligj." Meqenëse këto fonde u ndanë më 22 prill, pragu i shpenzimeve ishte i njohur për garuesit vetëm tetë ditë pas fillimit të fushatës.

⁶⁹ Sipas formularit të raportimit, monitoruesit e KQZ-së paraqesin informacione për zyrat zgjedhore, materialet e fushatës, aktivitetet/eventet e fushatës dhe abuzimet me burimet shtetërore, por nuk u kërkohet të llogarisin apo vlerësojnë totalin e shpenzimeve të kryera nga subjektet zgjedhore. Sipas rregullores përkatëse të KQZ-së, raportet e ndërmjetme në KQZ duhet të dorëzohen çdo 10 ditë, ndërsa raporti përfundimtar paraqitet shtatë ditë pas ditës së zgjedhjeve.

⁷⁰ KQZ-ja më 6 maj miratoi një vendim që partitë politike, koalicionet dhe kandidatët për kryetar bashkie do të duhet të dorëzojnë raporte financiare nëpërmjet një Sistemi të ri të Raportimi Financiar Online që lejon raportimin në format të lexueshëm nga pajisja.

transparencën e financimit të fushatës.⁷¹ Afati i raportit vjetor nuk parashikohet në ligj, por përcaktohet nga KQZ-ja, në mospërputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁷²

Media

Kushtetuta mbron lirinë e medias dhe të drejtën e informimit dhe ndalon censurën. Megjithatë, dispozitat ligjore në lidhje me aksesin në informacion nuk zbatohen në mënyrën e duhur dhe shpifja mbetet një vepër penale e dënueshme me gjoba të rënda.⁷³

Fushata zgjedhore u zhvillua në një mjedis mediatik të karakterizuar nga disa probleme sistematike që ndikojnë në lirinë e medias dhe gazetarinë. Ndërkohë që ekziston një larmi organesh mediatike, ato operojnë në një treg të kufizuar reklamash dhe autonomia e tyre ka pësuar rënie në mënyrë progresive për shkak të përqendrimit të pronësisë së medias dhe kontrollit të ushtruar nga interesat e ndërthurura të biznesit dhe politikës.⁷⁴ Të dy këta faktorë ndikojnë në pavarësinë editoriale të medias dhe i bëjnë gazetarët të cenueshëm ndaj presionit dhe autocensurës. Praktika e përhapur mes partive kryesore politike dhe institucioneve publike për t'i ofruar mediave pamjet e para-regjistruara ose të drejtpërdrejta nga ngjarjet politike është një problem i rëndësishëm i vërejtur nga të gjithë bashkëbiseduesit e mediave të MVZ-së së ODIHR-it, pasi mediat mbështeten shumë në pamje të tilla, në vend që të prodhojnë vetë përmbajtjen e tyre. Retorika diskredituese nga politikanët, pengesat për të aksesuar informacionin publik dhe kushtet e pasigurta të punës janë faktorë të tjerë kryesorë që prekin profesionistët e medias.⁷⁵ Këto sfida të njëpasnjëshme ndikojnë në aftësinë e mediave kryesore për të kryer raportime të pavarura dhe investigative.

Mbulimi i fushatës në mediat elektronike rregullohet nga Kodi Zgjedhor. Rregullat për ndarjen e kohës mediatike në programet e lajmeve dhe ato informative u japin partive kryesore parlamentare një avantazh mjaft domethënës.⁷⁶ Dispozitat për transmetim pa pagesë në transmetuesin publik *RTSH* sigurojnë shikueshmëri për të gjithë garuesit në zgjedhje, bazuar në përfaqësimin e tyre parlamentar.⁷⁷ Përmbajtja e prodhuar nga partia në programet e lajmeve lejohet, duke mundësuar kështu këtë praktikë kontroverse.⁷⁸ Publiciteti zgjedhor me pagesë në mediat transmetuese lejohet dhe i

⁷¹ [Neni 7.3 i Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit \(UNCAC\) të vitit 2003](#) rekomandon Shtetet Palë të marrin masa legjislative dhe administrative “për të rritur transparencën në financimin e kandidatave për poste publike të zgjedhura”. Neni 23(4) i Ligjit për Partitë Politike parashikon: “Gjatë vitit zgjedhor, raportet financiare të partisë duhet të dorëzohen së bashku me raportin financiar të fushatës zgjedhore.”

⁷² Paragrafi 261 i [Udhëzimeve të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias Për rregullimin e partive politike \(botimi i dytë\)](#): “Afati i fundit për dorëzimin e raportit përfundimtar pranë organit mbikëqyrës duhet të përcaktohet saktësisht në ligj.”

⁷³ Kodi Penal parashikon gjoba deri në 3 milionë lekë (rreth 26800 euro).

⁷⁴ Televizioni mbetet burimi kryesor i informacionit politik, megjithëse konsumi i mediave online po rritet. [Raporti i progresit i BE-së i vitit 2022](#) vuri në dukje se: “Grupet e biznesit të profilit të lartë kanë rritur depërtimin e tyre ekonomik në tregun mediatik (...). Organizatat dhe aktivistët e medias kanë vazhduar të ngrenë shqetësime për përdorimin e kanaleve mediatike për të promovuar interesat ekonomike të pronarëve dhe axhendat politike. Përqendrimi i tregut dhe audiencës dhe mungesa e transparencës së financimit të medias vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese për sa i përket lirisë së medias në vend”.

⁷⁵ Sipas shumicës së bashkëbiseduesve të MVZ-së të ODIHR-it, Agjencia e re për Media dhe Informim ([MIA](#)), e krijuar në shtator të vitit 2021 me synimin e deklaruar për të lehtësuar aksesin në informacion, ka qasje të mëtejshme të centralizuar në informacionin publik.

⁷⁶ Partitë që fituan mbi 20 për qind të vendeve në zgjedhjet e fundit parlamentare duhet të marrin dyfishin e mbulimit të partive të tjera parlamentare në lajme dhe programe informative. Mbulimi për partitë joparlamentare është lënë në diskrecionin e transmetuesve, por nuk duhet të kalojë mbulimin e ofruar për partitë parlamentare me më pak se 20 për qind të mandateve. Dispozitat e rrepta që rregullojnë ndarjen e kohës së transmetimit për subjektet zgjedhore u kritikuan nga disa bashkëbisedues mediatikë.

⁷⁷ [Vendimi nr. 352 i KQZ-së](#) parashikonte 50 minuta në televizionin publik dhe 30 minuta në radio për PS-në dhe PD-në, partitë e tjera parlamentare morën nga 25 minuta në televizion dhe 15 minuta në radio dhe partitë joparlamentare secila nga 10 minuta në televizion dhe në radio.

⁷⁸ Megjithatë, Kodi Zgjedhor kërkon që ky material të jetë i emërtuar qartë si i tillë.

nënshtrohet një sërë kufizimesh.⁷⁹ Kritere të tilla nuk zbatohen për mediat online. Ky boshllëk ligjor, i cili krijon një standard të dyfishtë për publicitetin e fushatës, u kritikua nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it.

Masat e transparencës janë vendosur në lidhje me publicitetin zgjedhor me pagesë në TV dhe radio, të cilat duhet të paraqesin informacione në lidhje me tarifat që i shkojnë KQZ-së. Megjithatë, në faqen e internetit të KQZ-së janë publikuar listat e çmimeve për 20 transmetues. Disa media paraqisnin tarifa për publicitetin gjatë periudhave kohore kur publiciteti është i ndaluar me ligj, ndërsa të tjera ofronin shërbime të marrëdhënies me publikun me tarifat përkatëse.

Rregullatori i medias, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), mbikëqyr pajtueshmërinë e transmetuesve me kriteret ligjore për mbulimin e fushatës.⁸⁰ AMA nisi monitorimin e saj më datë 14 prill dhe i dorëzoi KQZ-së raporte ditore dhe periodike, të cilat u publikuan në faqen e internetit të KQZ-së. Raportet treguan se shumica e shkeljeve të vërejtura kishin të bënin me mosdërgimin e regjistrimeve të materialit të transmetuar tek AMA, si dhe shkelje të lidhura me reklamat elektorale. Pas gjetjeve të AMA-s, KQZ-ja vendosi një sërë sanksionesh ndaj transmetuesve për shkeljet e konstatuara, përgjithësisht në përputhje me rekomandimet e AMA-s.⁸¹ Gjithashtu, u gjetën pabarazi në mbulimin mediatic, ku KQZ-ja u kërkoi transmetuesve të jepnin kompensim për partitë e nënpërfaqësuar.

Monitorimi i medias nga MVZ-ja e ODIHR-it tregon se mbulimi mediatic u përqendrua kryesisht tek kryetarët e partive kombëtare, si dhe tek kandidatët për kryetar bashkie të Tiranës, me mbulim të kufizuar të kandidatëve të tjerë.⁸² Fushata mediatike u karakterizua nga sulme personale të përsëritura mes politikanëve, premtime të përgjithshme dhe mungesë debatesh mes kandidatëve. Vëmendje e kufizuar iu kushtua nga kandidatët dhe nga media politikave dhe çështjeve të rëndësishme në nivel vendor. Transmetuesit përdorën më së shumti ato që dukeshin si materiale partiake të regjistruara paraprakisht, rrallëherë me emërtime të burimit, në programet e tyre të lajmeve, duke mos siguruar një mbulim gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës.

Mbulimi politik në të gjitha mediat e monitoruara u përqendrua kryesisht tek PS-ja (40 përqind), “Bashkë fitojmë” (37 përqind) dhe në shkallë më të ulët PD (15 përqind). Së bashku ata morën 92 përqind të mbulimit total zgjedhor të monitoruar, duke treguar një përqëndrim të qartë të mbulimit të vetëm tre aktorëve. Në programet e saj të lajmeve dhe informacionit, televizioni publik RTSH ofroi kohën më të madhe të transmetimit për PS-në (43 përqind) dhe për “Bashkë fitojmë” (35 përqind), ndërsa PD-ja mori përkatësisht 17 përqind. Në TV Klan, PS mori 39 përqind, “Bashkë fitojmë” 35 përqind dhe PD, 21 përqind. Top Channel i kushtoi PS-së 51 përqind, ndërsa “Bashkë fitojmë” dhe PD-së, respektivisht 32 dhe 6 përqind. “Bashkë fitojmë” mori mbulimin më të gjerë në Vizion+ (40 përqind), e ndjekur nga PS-ja (33 përqind) dhe PD-ja (16 përqind). A2 CNN e fokusoi mbulimin e saj tek PS-ja (41 përqind), “Bashkë fitojmë” (40 përqind) dhe PD-ja (16 përqind). Toni i mbulimit ishte kryesisht neutral ose pozitiv tek të gjitha televizionet e monitoruara, me përjashtim të Top Channel, i cili i dha PS-së një mbulim (29 përqind) mbi mesataren e mbulimit pozitiv dhe një mbulim paksa negativ për “Bashkë Ne Fitojmë (7 përqind).

⁷⁹ Të drejtën e blerjes së publicitetit politik në televizion dhe radio e kanë vetëm subjektet zgjedhore dhe janë vendosur limite për volumnin total të kohës që mund të blihet. Transmetuesit duhet të aplikojnë të njëjtat tarifa për të njëjtën kohë dhe reklama e fushatës duhet të transmetohet nga ora 15:00 deri në 18:00 dhe nga ora 21:00 deri në 24:00.

⁸⁰ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në pikëpyetje efikasitetin rregullator të AMA-s dhe aftësinë e saj për të zbatuar sanksione gjatë periudhës së fushatës.

⁸¹ Në raportet e saj periodike, AMA propozoi mjete juridike kundër shkeljeve të vërejtura. Vendimet për sanksionet ndaj shkeljeve i takojnë KQZ-së. Një pjesë e madhe e transmetuesve nuk respektuan vendimin e KQZ-së.

⁸² Nga data 14 prill deri më 14 maj, MVZ-ja e ODIHR-it kreu monitorim në kohën kryesore të pesë stacioneve televizive (RTSH-1 publike dhe katër kanale private: Top Channel, TV Klan, Vizion Plus dhe A2 CNN).

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore

Kodi Zgjedhor parashikon rregulla të detajuara dhe garanci procedurale të përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Procedura e ankimit administrativ është e shtjelluar dhe përfshin garanci të procesit të rregullt ligjor.⁸³ Megjithatë, vetëm garuesit, interesat e ligjshëm të të cilëve preken, mund të parashitrojnë ankime në KQZ kundër vendimeve të KZAZ-së, brenda tre ditëve nga shpallja e vendimit.⁸⁴ Vëzhguesit mund të apelojnë vetëm mohimin e akreditimit të tyre dhe zgjedhësit kanë të drejtë të paraqesin vetëm ankesa në lidhje me përfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁸⁵

Vendimet e Komisionerit dhe të KZAZ-ve mund të ankimohen në KAS, e cila duhet të vendosë brenda dy ditëve nga data e paraqitjes.⁸⁶ Vendimet e KAS-së dhe të Rregullatorit mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor), vendimet e të cilit janë të formës së prerë.⁸⁷ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, deklaruan se futja e KAS-it brenda strukturës së KQZ-së, e ka bërë më kompleks sistemin e trajtimit të mosmarrëveshjeve zgjedhore.⁸⁸ Gjithashtu, bashkëbisedues të tjerë të MVZ-së së ODIHR-it, ngritën shqetësime në lidhje me vendimmarrjen e njëanshme të KAS-it, duke sfiduar kështu perceptimin e paanshmërisë së këtij organi.

Që nga data 12 maj, KAS-i mori 42 ankesa, kryesisht në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. KAS-ja mori 20 vendime në lidhje me sanksionet për abuzim me burimet publike dhe shkelje të tjera të lidhura me fushatën dhe vendosi sanksione në 17 raste. Sanksionet për këto vepra variojnë nga 2500 lekë (23 euro) deri në 100 000 lekë (900 euro). KAS-ja gjykoj ankesat në seanca publike, me pjesëmarrjen e palëve në çështje. Megjithatë, në disa raste, seancat e KAS-së u shpallën disa orë më parë.⁸⁹

Kolegji Zgjedhor gjykoj 13 ankesa, brenda afatit dhe në seanca publike. Që nga data 3 maj, KQZ-ja ka marrë 416 raporte nga OSHC-të dhe subjektet zgjedhore për mosraportimin e pretenduar të aktiviteteve publike, abuzimin me burimet publike dhe shkelje të tjera të lidhura me fushatën. Komisioneri iu adresua 341 raporte duke kërkuar vendosjen e sanksioneve ose dhënien e njoftimeve për organet publike.

Që nga data 12 maj, MVZ-ja e ODIHR-it është informuar për 54 raporte për shkeljet e zgjedhjeve të marra nga zyrat e policisë në të gjithë vendin, të cilat janë nën hetim, duke përfshirë 20 raste të korrupsionit pasiv dhe 25 raste të blerjes së votës. Shkeljet zgjedhore që lidhen me korrupsionin ndiqen penalisht nga SPAK. SPAK-u njoftoi MVZ-në e ODIHR-it se që nga data 12 maj, janë marrë 13 raporte lidhur me zgjedhjet dhe kanë filluar 6 hetime penale paraprake, duke përfshirë 4 të tilla për blerje votash.

⁸³ Ankesat që nuk plotësojnë kushtet formale mund të riparaqiten me korrigjime brenda 24 orëve.

⁸⁴ Ankesat në lidhje me rezultatet e zgjedhjeve mund të parashitrohen brenda pesë ditëve.

⁸⁵ Seksioni II.3.3.f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias](#) rekomandon që “Të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën elektorale në fjalë duhet të kenë të drejtën e ankimit. Një kuorum i arsyeshëm mund të vendoset për ankimitet e votuesve për rezultatet e zgjedhjeve.”

⁸⁶ Dhjetë ditë në rast të rezultateve kontestuese të zgjedhjeve.

⁸⁷ KAS-ja ka një afat dy-ditor dhe Kolegji Zgjedhor ka 10 ditë për të vendosur për ankimitet apo ankesat e marra. Të dyja instancat kanë 10 ditë për të vendosur për rastet e rezultateve të zgjedhjeve.

⁸⁸ Sipas rregullores së procedurës, pas regjistrimit të një ankese administrative, hidhet shorti për të caktuar një relator nga radhët e anëtarëve të KAS-ë, i cili verifikon nëse një ankesë është e pranueshme. Nëse një ankesë ka mangësi, ajo mund të kthehet për korrigjime. Nëse një ankesë pranohet, një seancë dëgjimore duhet të zhvillohet ndërmjet 24 dhe 48 orësh pas kësaj.

⁸⁹ MVZ-ja e ODIHR-it u informua se KQZ-ja përdor email për të ftuar palët në një rast të caktuar, për të përshpejtuar komunikimin.

Vëzhgimi i Zgjedhjeve

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin qytetar dhe ndërkombëtar të të gjitha fazave të procesit zgjedhor. Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi 443 vëzhgues qytetarë nga 9 organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe 407 vëzhgues ndërkombëtarë nga 16 organizata dhe 12 ambasada.

Partitë dhe koalicionet parlamentare kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ. Subjektet e tjera zgjedhore mund të emërojnë përfaqësues vetëm gjatë periudhës zgjedhore. Pasi të regjistrohen, subjektet zgjedhore mund të caktojnë një vëzhgues në çdo KZAZ dhe KQV ku kandidojnë, si dhe në çdo tryezë numërimi në QNV-të përkatëse. Koalicionet, pavarësisht nga numri i partive brenda, mund të delegojnë deri në tre përfaqësues për komision ose tryezë numërimi. Ndryshe nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, vetëm vëzhguesit e partive kanë të drejtë të marrin kopje të protokolleve të rezultateve të numërimit dhe tabulateve.

Disa OSHC monitoruan përdorimin e burimeve administrative ose shkeljet e rregulloreve të fushatës dhe depozituan shumicën e denoncimeve në KQZ. Disa OSHC informuan MVZ-në e ODIHR-it se për shkak të burimeve të kufizuara financiare, ato do të dërgonin vetëm një numër të vogël vullnetarësh për të vëzhguar ditën e zgjedhjeve.

Dita e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve në përgjithësi ishte paqësore, por u ndikua negativisht nga raste të shumta ndërhyrjesh të partive në proces, si dhe nga probleme teknike dhe procedurale. Në disa raste, vëzhguesit e MNVZ-së nuk u lejuan të vëzhgonin proceset e votimit dhe numërimit. KQZ-ja njoftoi një pjesëmarrje prej 36.3 përqind nga të gjithë zgjedhësit e regjistruar, përfshirë dhe ata jashtë vendit. Ajo filloi publikimin e rezultateve paraprake të zgjedhjeve për kryetar bashkie deri në nivelin e qendrës së votimit, rreth orës 23:00 të natës së zgjedhjeve, duke treguar transparencë.

Procesi i hapjes u vlerësua negativisht në 40 nga 102 qendrat e votimit të vëzhguara. Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën probleme në vendosjen dhe funksionimin e EID-ve, në disa raste të shkaktuara nga mosparaqitja në punë e operatorit të EID-së (26 raporte), nga KQV-ja, duke mos u treguar të gjithë të pranishmëve se kutitë e votimit ishin bosh (24 raporte) dhe mosdepozitimi i procesverbaleve të vulosjes së kutive të votimit (10 raporte). Në 17 qendra votimi të vëzhguara, joanëtarë të KQV-ve, shpesh vëzhgues dhe aktivistë partiakë ndërhyrën gjatë hapjes. Dy të tretat e qendrave të votimit të vëzhguara, u hapën për votim me më shumë se 15 minuta vonesë dhe shtatë qendra me më shumë se një orë vonesë.

Vëzhguesit e MNVZ-së e vlerësuan negativisht votimin në 7 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, i cili është një numër i lartë shqetësues. Ndërkohë që e karakterizuan procesin brenda shumicës së qendrave të votimit si të qetë dhe pa ndërprerje, ata vërejtën probleme jashtë shumë qendrave të votimit.

Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën tregues që votuesit nxiteshin ose detyroheshin të votonin për një parti të caktuar, jashtë ambjenteve të 3 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, dhe në 11 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, njerëz të ndryshëm nga anëtarët e KQV-së mbanin shënim zgjedhësit që kishin votuar. Në 4 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, u vërejtën persona të paautorizuar, zakonisht aktivistë partish dhe në 6 përqind të tyre, persona të ndryshëm nga anëtarët e KQV-së, kryesisht vëzhgues dhe aktivistë partish, ndërhyrën ose udhëhoqën procesin e votimit. Tension apo trazira u raportuan në ambjentet e jashtme të 2 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara dhe 2 përqind brenda tyre. Vënia nën presion e votuesve brenda qendrave të votimit, u raportua për 1 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. Vëzhguesit e partive, ishin të pranishëm në 86 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit qytetarë, ishin të pranishëm

vetëm në 6 përqind të tyre; në disa raste, vëzhguesit qytetarë dukej se përfaqësonin *de fakto* interesat e një partie politike.

EID-et nuk funksiononin, ose operatori i EID-it nuk ishte paraqitur në punë në 9 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. Në rreth 20 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara ku funksiononin EID-të, jo çdo votues në listën e zgjedhësve mund të identifikohet nga EID-ja. Procedurat në lidhje me përdorimin e bojës, një mbrojtje e rëndësishme kundër votimit të shumëfishtë, nuk u respektuan gjithmonë: në 27 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, jo të gjithë zgjedhësit u kontrolluan për gjurmë boje që nuk mund të fshihej dhe në 11 përqind të tyre, jo të gjithë zgjedhësve iu bë shënimi me bojë përpara se të votonin. Në 30 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, një ose më shumë zgjedhës që nuk ishin në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi u kthyen mbrapsht ose u ridrejtuan në qendrën e duhur të votimit.

Procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, por vëzhguesit e MNVZ-së raportuan se në 10 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, jo të gjithë zgjedhësit plotësuan fletëvotimet e tyre në fshehtësi. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan gjithashtu, një sërë shkeljesh procedurale, duke përfshirë votimin në grup (12 përqind) dhe votimin me përfaqësues (3 përqind). Në 1 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, kutitë e votimit nuk ishin të vulosura siç duhet dhe në 5 përqind të tyre numrat serialë të vulave të kutive të votimit nuk ishin regjistruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Vëzhguesit e MNVZ-së, në 3 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara vërejtën përpjekje për të ndikuar tek zgjedhësit, se për kë duhet të votonin, dhe në 3 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, i njëjti person, në kundërshtim me ligjin, ndihmonte më shumë se një zgjedhës. Në 4 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, kamera e monitorimit nuk funksiononte. Në numrin e kufizuar të qendrave të votimit me votim elektronik të vëzhguar, vëzhguesit e MNVZ-së shpesh vërejtën se, veçanërisht, zgjedhësit e moshuar kishin probleme në përdorimin e pajisjeve të votimit dhe se ndihma që iu jepej këtyre votuesve cënonte fshehtësinë e votës.

Vëzhguesit e MNVZ-së, raportuan se 6 përqind e qendrave të votimit të vëzhguara ishin të tejmbushura me njerëz. Në 5 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, infrastruktura nuk ishte e përshtatshme për të kryer votimin. Rreth 60 përqind e qendrave të votimit nuk ishin të aksesueshme në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe në 28 përqind të tyre, infrastruktura nuk ishte e përshtatshme për zgjedhës të tillë.

Mbyllja, përgjithësisht u vlerësua pozitivisht, me përjashtim të tetë nga 100 qendrat e votimit të vëzhguara, ku procedurat e duhura u ndoqën pothuajse në të gjitha prej tyre. Marrja e materialit zgjedhor në 58 (QNV) të vëzhguara, u vlerësua pozitivisht në të gjitha raportet, me përjashtim të tre prej tyre. Procedurat u ndoqën, por në rreth një në pesë QNV, u vu re mbipopullim ose vendi i pritjes nuk ishte i përshtatshëm për dorëzimin e materialeve zgjedhore. Në tetë QNV, një ose më shumë kuti votimi u deklaruan të parregullta.

Numërimi i votave u vlerësua pozitivisht në 170 nga 193 raportet e paraqitura nga 60 QNV. Në shumicën e rasteve u cilësua si i ngadaltë, por profesional dhe metodik. Të gjitha ambientet e QNV-ve të vëzhguara janë vlerësuar si të përshtatshme. Tension u raportua nga pesë QNV dhe ndërhyrje nga aktivistë partish nga dy të tilla. Vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në të gjitha numërimet e vëzhguara, përveç dy të tillave, dhe vëzhguesit qytetarë në një të tretën. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan raste kur grupet e numërimit nuk ndoqën të gjitha procedurat e përcaktuara të rakordimit, veçanërisht në rastet kur Procesverbali Përmbyllës i KQV-së nuk gjendej në kutinë e votimit. Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan, gjithashtu, raste kur ana e pasme e vulosur e fletëve të votimit nuk ishte ekspozuar siç duhet ndaj kamerës (12 raste) dhe raste kur përcaktimi i vlefshmërisë së fletëvotimeve nuk ishte i arsyeshëm ose konsistent (tre dhe katër raporte respektivisht). Në 15 numërimet, numri i fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit nuk përputhej me numrin e

votuesve që kishin marrë fletëvotim. Në nëntë raste u kërkua rinumërim dhe në një rast kërkesa për rinumërim u refuzua.

Në ditën e zgjedhjeve, KQZ-ja mori 44 denoncime, kryesisht në lidhje me parregullsitë gjatë votimit, duke përfshirë blerjen e votave, vënien nën presion të votuesve dhe votimin në grup. Policia e Shtetit njoftoi se ka identifikuar pesë krime zgjedhore dhe se një shtetas u arrestua, ndërsa tetë u proceduan në gjendje të lirë.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Ekziston një përkthim jozyrtar në gjuhën shqipe.*

INFORMACIONE & FALËNDERIME PËR MISIONIN

Tiranë, 15 maj 2023 – Kjo deklaratë e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake është rezultat i një përpjekjeje të përbashkët që përfshin Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Parlamentin Evropian (PE) dhe Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi). Vlerësimi u realizua për të përcaktuar nëse zgjedhjet ishin në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standardet e Këshillit të Evropës, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe sipas legjisllacionit kombëtar. Të gjitha institucionet e përfshira në këtë Mision Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve kanë miratuar Deklaratën e Parimeve të vitit 2005 për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve.

Ambasadorja Audrey Glover është Kryetare e MVZ-së së ODIHR-it, e angazhuar që nga data 6 prill. Delegacioni i Kongresit u udhëhoq nga Stewart Dikson, zëdhënës tematik i Kongresit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore dhe Rajonale dhe nënkryetar i Këshillit për Zgjedhje Demokratike. Sven Simon kryesoi Delegacionin e PE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve.

Kjo Deklaratë e Gjetjeve dhe Konkluzioneve Paraprake jepet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga mbarëvajtja e fazave të mbetura të procesit zgjedhor, duke përfshirë numërimin, tabelimin dhe shpalljen e rezultateve, si dhe trajtimin e ankesave ose ankimimeve të mundshme pas zgjedhjeve. ODIHR do të nxjerrë një raport përfundimtar gjithëpërfshirës, duke përfshirë rekomandime për përmirësime të mundshme, rreth tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Kryetari i Delegacionit të Kongresit do të paraqesë në tetor, një raport në sesionin e ardhshëm të Kongresit në Strasburg. Kreu i Delegacionit të PE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve do të raportojë mbi rezultatet e misionit më 22 maj 2023 në takimin e ardhshëm të Delegacionit të Parlamentit Evropian në Komitetin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri (SAPC).

MVZ-ja e ODIHR-it përfshin 14 ekspertë në kryeqytet dhe 24 vëzhgues afatgjatë të vendosur në të gjithë vendin. Në ditën e zgjedhjeve, u angazhuan 246 vëzhgues nga 31 vende, duke përfshirë 216 vëzhgues të vendosur nga ODIHR, si dhe një delegacion 10 anëtarësh nga PE dhe një delegacion 20 anëtarësh nga Kongresi. Mes vëzhguesve pati 51 përqind femra. Hapja u vëzhgua në 102 qendra votimi dhe votimi u vëzhgua në më shumë sesa 940 qendra votimi në të gjithë vendin. Procedurat e mbylljes u respektuan në 100 qendra votimi. Dorëzimi i materialit zgjedhor dhe fazat fillestare të numërimit të votave u vëzhgua në 60 qendra numërimi votash.

MNVZ-ja dëshiron të falënderojë autoritetet e Republikës së Shqipërisë për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për ndihmën e tyre. MNVZ-ja dëshiron gjithashtu të shprehë mirënjohjen e saj për institucionet e tjera shtetërore, partitë politike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar për bashkëpunimin e tyre.

Për më shumë informacione, ju lutemi kontaktoni:

Ambasadoren Audrey Glover, Kryetare e MVZ-së së ODIHR-it, në Tiranë (+355-68-584 0900) deri më 25 maj;

Katya Andrusz, zëdhënëse e ODIHR-it (+48 609 522 266), ose Kakha Inaishvili, këshilltar zgjedhor i ODIHR-it, në Varshavë (+48 691 060 501);

Stephanie Poirel, Congress (+33 3 90 21 51 84);

Raffaele Luise, EP (+32477855324)

Adresa e MVZ-së së ODIHR-it:

Hotel Mak Albania, kati 3

Sheshi Italia 2

Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355-68-584 0900; email: office@odihr.al